



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

PROJEKTI I BURIMEVE UJORE DHE UJITJES

Projekti Nr. P121186; Huaja Nr. 8211-AL

Shpall

KËRKESË PËR SHPREHJE INTERESI

Për Shërbimet e Konsulencës Individuale

“Konsulent Lokal për të mbështetur MBZHR për Mbikqyrjen Teknike për Kontratën e punimeve Civile dhe të Supervizionit për “Rehabilitimin e Skemës së Ujitjes Murriz-Thana - Krutja (V1 & V2)” (Nr. Referencës së Prokurimit MAFCP/CS/006C)

Kjo kërkesë për shprehje interesi është vazhdim i Njoftimit të Përgjithshëm të Prokurimit për këtë projekt, publikuar në faqen e Zhvillimit të Biznesit në 25 Maj 2010; në Njoftimin e Përgjithshëm, përditësuar në 20 Dhjetor 2012, me referencë në Zhvillimin e Biznesit Nr. WB5260-12/12.

Qeveria e Shqipërisë ka marrë një hua nga Banka Botërore në shumën ekuivalente 31 milion Euro, për financimin e Projektit të Burimeve Ujore dhe Ujitjes dhe parashikon të aplikojë pjesë të këtij fondi për pagesën e Shërbimit të Konsulencës Individuale për **“Konsulent Lokal për të mbështetur MBZHR për Mbikqyrjen Teknike për Kontratën e punimeve Civile dhe të Supervizionit për Rehabilitimin e Skemës së Ujitjes Murriz-Thana - Krutja (V1 & V2)”** (me kohë të pjesshme).

➤ **Objektivat e Detyrës**

Objekti i këtij Shërbimi Konsulencë është të asistojë MBZHR dhe departamentet përkatëse në të gjitha çështjet teknike lidhur me menaxhimin e kontratës së Punimeve Civile për **“Rehabilitimin e skemës së Ujitjes Murriz – Thanë, Krutje (V1 & V2)”**, si dhe të kontratës për **“Shërbimet e Supervizionit për punimet e rehabilitimit të skemës së Ujitjes Murriz – Thanë, Krutje (V1 & V2)”** dhe për çdo problem mjedisor, që mund të identifikohet dhe që kërkon masa lehtësuese.

Qëllimi final i Shërbimeve të Konsulencës është që punimet të jenë teknikisht të qëndrueshme dhe të jenë kryer në kohën e duhur dhe brenda buxhetit të kontratës. MBZHR kërkon asistencën e Inxhinierit/Konsulent Lokal për t’u siguruar që Punimet Civile për **“Rehabilitimin e skemës së Ujitjes Murriz – Thanë, Krutje (V1 & V2)”** janë kryer në përputhje me Projektin Teknik, Kushtet e Kontratës, Specifikimet Teknike dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare dhe duke përmblusur pritshmëritë e aktorëve kryesorë (MBZHR, Bankës Botërore, Përfituesve Lokalë, Autoriteteve Qëndrore dhe Lokale, Drejtorive të Ujitjes dhe Kullimit etj.). Gjithashtu, duhet të sigurojë që Kompania Supervizuese ofron shërbime në përputhje me Kushtet e Kontratës dhe Termat e Referencës (TeR) si dhe me praktikatat më të mira të menaxhimit, për të siguruar standarte të larta të cilësisë dhe përfundimin e punimeve brenda afatit dhe buxhetit.

➤ **Fusha e punës**

Konsulenti Lokal pritet të ndërmarrë detyrat, përfshirë punën në terren dhe shqyrtimin në zyrë, por, jo domosdoshmërisht të kufizohen në detyrat e listuara më poshtë:

A. Administrimin e Kontratës së Punimeve Civile për “Rehabilitimin e skemës së Ujitjes Murriz –

Thanë, Krutje (V1 & V2)” (Nr. Ref. No. MAFCP/W/ICB/005), në përputhje me Kushtet e Kontratës dhe Specifikimet Teknike, si dhe me Urdhërin e Klientit për monitorimin, kontrollin, koordinimin dhe mbështetjen për zbatimin e Kontratës, deri në procedurat për dorëzimin përfundimtar, më konkretisht:

- Dhënien e të drejtës Kontraktorit për akses në zonë dhe zotërimin e zonës;
- Lëshimin e urdhërave për fillimin e punimeve;
- Shqyrtimin dhe miratimin e programeve të punës të Kontraktorit pas miratimit nga Supervizori;
- Shqyrtimin dhe miratimin e azhornimeve topografike pas miratimit nga Supervizori;
- Të ndërmarrë vizita në terren për të vërtetuar:
- ✓ Burimin e materialeve të ndërtimit;
- ✓ Të gjitha analizat laboratorike, pas kontrollit të kujdesshëm të të gjithë dokumentacionit;
- ✓ T’i kushtojë vëmendje të vecantë punimeve të maskuara, kontrollit të të gjithë dokumentacionit dhe nuk duhet të lejojë mbulimin e tyre pa u siguruar që janë zbatuar Specifikimet Teknike dhe udhëzimet e Supervizorit;
- ✓ Konsulenti mund të vendosë të bëjë matje e të marrë kampione dhe të shqyrtojë hartat topografike të disponueshme për të konfirmuar cilësinë dhe sasinë e punimeve të kryera;
- Shqyrton Dokumentacionin Teknik:
- ✓ Shqyrton Projektet e Detajuara dhe Specifikimet Teknike;
- ✓ Pranon, shqyrton dhe miraton situacionet e Kontraktorit dhe dokumentacionin mbështetës për pagesat mujore, pas certifikimit nga Supervizori dhe bazuar dhe në inspektimet e saj/tij në terren, certifikon përfundimin pjesor ose total të punimeve, në krahasim me buxhetin e projektit dhe pagesat e kryera, duke përfshirë dhe projektin ose ndonjë ndryshim në punime gjatë procesit;
- ✓ Konsulenti do të dorëzojë situacionet e certifikuara dhe dokumentacionin mbështetës tek Drejtori i Drejtorise se Fisibilitetit dhe Konceptimit të Projekteve në MBZHR për kontroll final dhe pranim, përpara se të procedohet për pagesë nga Projekti i Burimeve Ujore dhe Ujitjes;
- ✓ Ofron ekspertizë dhe asistencë Teknike lidhur me zbatimin e projektit, përfshirë shqyrtimin e amendimeve të propozuara të kontratave, kur është e nevojshme
- ✓ Shqyrton “As built”/vizatimet sipas ndërtimit, të dorëzuara nga Supervizori dhe plotësimin e tyre, përfshirë të gjitha modifikimet në projekt dhe urdhërat për ndryshim (VO) të ekzekutuara;
- ✓ Për çdo urdhër për ndryshim ose amandim të dhënë, bazuar në inspektimet e saj/tij në terren të shënojë justifikimet, plotësimin e dokumentacionit Teknik për këto amendime, kontrollojë dhe miratojë ndryshimet në Preventiv për sa i përket sasive, cilësisë, aplikimeve të cmimeve njësi dhe vlerës totale të Kontratës, aprovimin (nëse ka) të statusit të pagesave dhe zbatimit fizik;
- ✓ Shqyrton, aprovon dhe pranon Raportet e progresit, përfshire ato të Periudhes së Përgjegjësisë për Defektet;
- ✓ Shqyrton, aprovon dhe pranon situacionet Përfundimtare të Kontraktorit dhe dokumentacionin mbështetës për punimet e kryera, pas certifikimit nga Supervizori dhe bazuar në vizitat e saj/tij në terren;
- ✓ Konsulenti do të dorëzojë situacionet Përfundimtare të certifikuara dhe dokumentacionin mbështetës tek Drejtori i Drejtorise se Fisibilitetit dhe Konceptimit të Projekteve në MBZHR për kontroll final dhe pranim, përpara se të procedohet për pagesë nga Projekti i Burimeve Ujore dhe Ujitjes;
- Kryen kolaudimin e punimeve, dorëzimin provizor dhe përfundimtar;

B. Administrimin e Kontratës për “Shërbimet e Supervizionit për punimet e rehabilitimit të skemës së Ujitjes Murriz – Thanë, Krutje (V1 & V2)” dhe monitorimin e performancës në përputhje me Kushtet e Kontratës, si dhe me Urdhërin e Klientit për monitorimin, kontrollin, koordinimin dhe mbështetjen për zbatimin e Kontratës, deri në procedurat për dorëzimin përfundimtar, më konkretisht:

- Kryen shqyrtimin nga pikëpamja Teknike të produkteve të dorëzuara për përputhshmërinë me Termat e Referencës, aprovimin dhe pranimin e tyre;
- Kontrollon dhe pranon kohëshënuesin (timesheets) e Supervizorit, pas aprovimit nga Drejtorët e Drejtorive të Ujitjes dhe Kullimit dhe bazuar në prezencën e konstatuar gjatë inspektimeve të saj/tij në terren;
- Këshillon MBZHR për të urdhëruar Kontraktorin ose Supervizorin të kryejnë testimet dhe procedurat në terren, kur kërkohet;

- Siguron që të gjitha aktivitetet në terren ndjekin kërkesat e MBZHR në të gjitha çështjet në lidhje me Planin e Menaxhimit Mjedisor (PMM) dhe Programit të Mirëmbajtjes;
- Monitorimi dhe raportimi për arritjen e Indikatorëve të Projektit kundrejt objektivave;

Konsulenti Lokal duhet t'i kushtojë vëmendje të vecantë dhe të kontrollojë me kujdes metodën e propozuar nga Kontraktori dhe të aprovuar nga Supervizori, konkretisht, për hedhjen e betonit të freskët në skarpatet anësore me pjerrësi 1:1. Ai/Ajo, bazuar në inspektimet në terren, do të shqyrtojë dhe miratojë raportin e vecantë të dorëzuar nga Supervizori në përfundim të punimeve të tilla, që përmbledh metodën e përdorur, zbatimin e punimeve dhe rezultatet.

Konsulenti do të ndërmarrë inspektime të rregullta në terren, si domosdoshmëri, për të vërtetuar punimet e përfunduara si dhe ndonjë inspektim shtesë kur rekomandohet në ndonjë situatë kritike (p.sh: gjatë ndërprerjes së punimeve në periudhën e vaditjes Maj – Shtator) ose sipas nevojave për vaditje. Ajo/Ai do të ndërmarrë, gjithashtu, 3 inspektime gjatë Periudhës së Përgjegjësisë për Defektet (një në cdo tremujor) dhe një në përfundim të kësaj periudhe.

➤ Kërkesat për Kualifikim dhe Eksperienca

Kandidati i përshtatshëm për këtë pozicion duhet të ketë kualifikimet në vijim:

- Diplomë Universitare në disiplina, që lidhen me Inxhinierinë e Ndërtimit, preferohet ne Hidroteknikë;
- Eksperiencë e përgjithshme pune, nga e cila të paktën 10 vjet experiencë profesionale në fushën e detyrës si Inxhinier Rezident/Inspektor dhe topograf (Hidroteknikë/Inxhinier Civil);
- Kombinimi i sfondit akademik dhe experiencës së punës është e dëshirueshme;
- Eksperiencë e provuar dhe aftësi teknike për të koordinuar projektet e infrastrukturës, preferohen punime ndërtimi/rehabilitimi në sistemet e ujitjes dhe kullimit, të demonstruar në të paktën 1-2 projekte;
- Eksperienca në projekte të financuara nga Banka Botërore do të jetë një avantazh;
- Njohuri dhe experiencë në menaxhimin e kontratave sipas FIDIC dhe Udhëzuesit e Bankës Botërore për Prokurimet do të konsiderohet një aset;
- Mbajtja e të dhënave, aftësi shumë të mira në të shkruar teknikisht dhe aftësi për të përgatitur raportet e progresit;
- Njohuri të gjuhës Angleze dhe njohuri kompjuterike janë të kërkuara;
- Licensë drejtim automjeti është e dëshirueshme;

➤ Afatet

Pritet që Konsulenti të ofrojë shërbimet duke filluar (planifikuar) në Qershor 2018. Detyrat për këtë Shërbim Konsulencë përfshijnë punën në terren dhe shqyrtimin në zyrë, total 138 ditë pune. Kohëzgjatja e pritshme e detyrës do të jetë 8 (tetë) muaj për një total 96 ditë gjatë zbatimit të Punimeve Civile dhe Kontratës së Supervizionit, dhe përveç kësaj, 3 (tre) muaj të tjerë (30 ditë në total): 2 (dy) muaj në përfundim të punimeve dhe 1 (një) në përfundim të Periudhës së Përgjegjësisë për Defektet për kontrollin final dhe arshivimin e dokumentacionit. Gjatë Periudhës së Përgjegjësisë për Defektet Konsulenti do të angazhohet 6 ditë në total. Nëse do të jetë nevoja, Konsulenti do të angazhohet dhe gjatë stinës së ujitjes (Maj – Shtator), 6 ditë ditë në total, për të asistuar MBZHR në menaxhimin e situatës, ndërsa punimet janë ndërprerë dhe Supervizori nuk do të jetë prezent ne terren.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) fton individë të kualifikuar të tregojnë interesin e tyre në ofrimin e shërbimeve. Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin: (i) një letër motivimi, duke nënvizuar avantazhet e tyre lidhur me këtë pozicion, (ii) Curriculum Vitae si dhe (iii) informacion, që tregon që ata kanë kualifikimet e kërkuara për kryerjen e Shërbimeve të Konsulencës, (iv) licencat përkatëse si dhe (v) referenca të ndryshme. Materialet duhet të dorëzohen në gjuhën Angleze.

Kriteret e shortlistimit janë:

1. **Kualifikimet e Përgjithshme**

- *Diplome Universitare sic kerkohet*
- *Kualifikimet dhe certifikata pas-universitare*

30 pikë

2. **Përshatshmëria për detyrën** 60 pikë
- *Eksperience Profesionale ne fushen e detyres si Resident Inxhinier*
 - *Eksperience e provuar dhe aftesi teknike ne punime ndertim/rehabilitim te sistemeve te ujitjes dhe kullimit*
3. **Gjuha, aftësi në kompjuter dhe të shkruar teknikisht** 10 pikë

Vëmendja e Konsulentëve të interesuar tërhiqet në paragrafin 1.9 të *Udhëzuesit të Bankës Botërore: Përzgjedhja dhe Punësimi i Konsulentëve nën kreditë dhe Grantet e IBRD dhe IDA, botimi Janar 2011*, ku përcaktohet politika e Bankës Botërore për konfliktin e interesit.

Metoda e përzgjedhjes që do të aplikohet është përzgjedhja e **Konsulentit Individual (IC)**, në përputhje me procedurat për përzgjedhjen e Konsulentëve Individualë të përcaktuara në *Udhëzuesin: Përzgjedhja dhe Punësimi i Konsulentëve nga Huamarrësit e Bankës Botërore, botimi Janar 2011*.

Konsulentët e interesuar mund të marrin informacion të mëtejshëm në lidhje me Termat e Referencës në faqen zyrtare të MBZHR: www.bujqesia.gov.al ose në adresën e mëposhtme, gjatë orarit zyrtar 08:00 - 16:30 (E hënë – E enjte) dhe 08:00 - 14:00 të Premten:

Z. Ilirjan LAME

Menaxher Projekti

Projekti i Burimeve Ujore dhe Ujitjes

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Adresa: Blv. "Dëshmorët e Kombit", Nr. 2, kp. 1001 Tiranë, Shqipëri

Tel: + 355 4 2226243 - 75129

e-mail: ilirjan.lame@bujqesia.gov.al

Shprehjet e Interesit duhet të dorëzohen jo më vonë se data **25 Maj 2018**: të printuara (personalisht ose me postë) në adresën e mëposhtme, brenda orarit zyrtar, dhe elektronikisht në adresën e e-mailit më sipër.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (Zyra e Protokollit)

Adresa: Blv. "Dëshmorët e Kombit", Nr. 2, kp. 1001 Tiranë, Shqipëri

Në vëmendje të: Znj. Aurora ALIMADHI

Sekretar i Përgjithshëm